

Dr. Eris DHAMO

Profil/Profile

Bio:

Eris Dhamo është lektore me kohë të plotë pranë Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale në Universitetin e Tiranës që nga viti 2014. Ajo u diplomua si punonjëse sociale nga i njëjti departament në vitin 2001 dhe në vitin 2012 përfundon studimet Master i Nivelit të Dytë në Kërkim Shkencor në Punë Sociale nga Universiteti i Tiranës. Ka mbrojtur gradën Doktor i Shkencave në vitin 2016, në fushën e gerontologjisë sociale, me fokus specifik cilësinë e jetës së të moshuarve. Fushat e saj të ekspertizës dhe interesit janë çwshtjet dhe politikat sociale, komunikimi për ndryshimin social dhe të sjelljes, administrimi social, kërkimi shkencor në shkenca sociale dhe metodat e integruara në punë sociale. Eksperiencat e saj në këto fusha përfshijnë jo vetëm mësimdhënien në nivel Bachelor dhe Master, por dhe punë studimore dhe kërkimore shkencore të fokusuar kryesisht në çështje si puna sociale me të moshuarit, cilësia e jetës, mirëqënia e shoqërisë, komunikimi për ndryshim social, etj. Kurrikulumit i saj përfshin edhe asistencë e këshillim për institucione dhe organizata lokale mbi realizimin me sa më cilësi të angazhimeve të tyre, kryesisht në kërkime, strukturimin e shërbimeve, administrimin e organizatave, organizimin e manualeve, ofrimin e trajnimeve, monitorimin, vlerësimin dhe planifikimin e ristrukturimeve të nevojshme, etj. Ka një përvojë të pasur në aktivizimin e shoqërisë civile, kryesisht në ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe në lobimin për të drejtat e njeriut. Është bashkëautore e emisionit radioviziv “Individi dhe Shoqëria”, në Radio Tirana 1 dhe RTSH. Ajo është autore dhe bashkautore e disa artikujve dhe librave të botuara kryesisht në vend, por dhe jashtë. Aktualisht ajo ligjeron kryesisht në programet Bachelor të departamentit mbi administrimin social dhe politikat e mbrojtjes sociale ndërsa në nivelin Master ligjeron lëndë të metodologjisë kërkimore mbi komunikimin, metoda të integruara në punë sociale, monitorim dhe vlerësim politikash sociale.